



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Predato Received / Delivered	16 01 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDINSHOCK	402/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1008/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1108/2022 të datës 15.11.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit - Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 16.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1008/2022 e datës 15.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.1540/2022 i datës 14.10.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 15.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 7093/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1008/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.1540/2022 të datës 14.10.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me të cilin i është refuzuar kërkesa për sistemim në pozitë të mesme drejtuese, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit për emërimin e zyrtarëve publikë si dhe për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 7093/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin e akt emërimit me Nr.781 të datës 02.12.2013; Vërtetimin me Nr.497 të datës 09.07.2021; Vendimin me Nr.14/144 të datës 04.05.2017; Vendimin me Nr.614/2020 të datës 06.05.2020; Vendimin me Nr.0194/2021 të datës 24.05.2021; Njoftimin 3506/2021 të datës 07.07.2021 nga KPMSHCK; Aktgjykimin A.nr.1640/21 të datës 30.06.2022; Vendimin Nr.1540/2022 të datës 14.10.2022; Vendimin A.nr.610/2021 të datës 27.09.2022 nga KPMSHCK; Raportin vjetor të vlerësimit të ankuesit për periudhën janar-dhjetor 2019 Nr.567 të datës 31.01.2020; Raportin vjetor të vlerësimit për vitin 2020 të datës 11.02.2021; Vlerësimin e punës për periudhën janar-maj 2020 të datës 18.06.2020; E-mailiat zyrtar të datës 17.10.2022 dhe 21.10.2022; Procesverbalin e datës 27.09.2022; Njoftimin e datës 27.09.2022 përmes e-mailit zyrtar; Parashtresën me numër 5655/2022 të datës 26.09.2022; Ankesën e ankuesit të datës 05.07.2021 në KPMSHCK; Akt emërimit të ankuesit Nr.Ref:DGJC/ARC-01/15 të datës 06.02.2015; Aktgjykimin me numër AA.nr.901/2019 të datës 06.08.2021; Aktgjykimin me numër A.nr.17/2018 të datës 04.10.2019; Njoftimin me numër 3506/2021 të datës 07.07.2021 nga KPMSHCK; Akt emërimit me numër Nr.Ref: DPD/ARC 135/13 të datës 31.01.2013; Vendimin Nr.289 të datës 15.03.2007; Kërkesën me numër 5167/2022 të datës 06.09.2022; Njoftimin me numër 4311/2022 të datës 23.08.2021 nga KPMSHCK; Kërkesën me numër 745 të datës 31.05.2021; E-mailat zyrtar të datës 25.06.2021, 09.06.2021, 31.05.2021, 24.05.2021. Vendimin me numër Nr.42/2017 të datës 16.02.2017; Ndryshimin e akt emërimit me numër 781 të datës 02.12.2013; Vendimin e datës 21.11.2012; Vendimin me numër 289 të datës 13.03.2007; Vazhdimin e emërimit të datës 05.01.2004 si dhe Certifikatat e bashkangjitura të ankuesit në shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin me Nr.14/144 të datës 04.05.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është konstatuar se ankuesi me datën 04.05.2017 është emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me mandat tre (3) vjeçar. Emërimi i ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil është bërë sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregullores Nr.06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të mandatit të rregullt, me datë 03.05.2020, sipas vendimit përkatës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi me datë 06.05.2020 sipas Vendimit me numër 614/2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme është caktuar ushtrues i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe atë nga data 04.05.2020 deri me datë 24.05.2021 kur është shfuqizuar me Vendimin me numër 0194/2021 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Rrjedhimisht, me datë 31.05.2021 ankuesi ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 745 në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për sistemimin e tij në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese, përkatësisht në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve të cilën e ka ushtruar para emërimit si Drejtor i Përgjithshëm i ARC-së, duke ju referuar kështu dispozitave të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 05.07.2021, me datën 27.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.610/2021 sipas të cilit ka detyruar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të vendos lidhur me kërkesën e datës 31.05.2021 me numër protokolli 745 të parashtruar nga ankuesi. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datën 14.10.2022 me Vendimin me Nr.1540/2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 31.05.2021 lidhur me sistemimin e tij në pozitë të kategorisë së mesme drejtuese, me arsyetimin se ankuesit i ka përfunduar mandati në kohen kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi me date 09.07.2020 nuk ka efekt retroaktiv.

Kundër Vendimin me Nr.1540/2022 të datës 14.10.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi me datën 15.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 7093/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase ankuesi pretendon se për shkak të ushtrimit të pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, deri me datë 24.05.2021 i njihet e drejtat e sistemit në pozitë të mesme drejtuese sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, respektivisht i njëjti kërkon që t'i mundësohet kthimin e tij në vendin e punës si Drejtor i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pozitë kjo të cilën e kishte mbajtur ankuesi para emërimit si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, si dhe organi përkatës i punësimit t'ia kompensoj të gjitha pagat për periudhën nga data e largimit nga puna respektivisht nga data 24.05.2021 deri me datën e plotfuqishmërisë së vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi me datën 09.07.2020, përkatësisht nenin 42 paragrafin 7 ku përcaktohet se: 7. *Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale*", si dhe paragrafin 8 ku përcaktohet se: 8. *Deri në emërimin në një pozitë sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 muajore, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se kjo normë juridike rregullon çështjen e sistemimit dhe kompensimin e zyrtarëve të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, apo zyrtarëve të lartë drejtues të cilëve ju është vazhduar edhe një mandat pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mirëpo në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, neni 42 paragrafi 7 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk ka fuqi retroaktive në raport me nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues të cilëve ju ka përfunduar mandati para se të hyje në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, siç është rasti i ankuesit të cilit i ka përfunduar mandati me datë 03.05.2020.*

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka marr parasysh vendimin se i njëjti ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, deri me datë 24.05.2021, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesit me Vendimin me Nr.14/144 të datës 04.05.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ishte emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil,

me mandat tre (3) vjeçar, dhe atë nga data 04.05.2017 deri me datë 03.05.2020 dhe se nga shkresat e lëndës rrjedh se të njëjtit nuk i është vazhduar mandati, mirëpo vetëm është caktuar ushtrues i detyrës se *Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil*, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit vendimi për caktimin e ankuesit si ushtrues i detyrës, pas përfundimit të mandatit të rregullt, nuk prodhon pasoja juridike në kuptim të krijimit të së drejtës për emërim, gjegjësisht sistemim në pozitë të mesme drejtuese në kuptim të nenit 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji i Këshillit vlerëson se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike me rastin e nxjerrjes se Vendimit me Nr.1540/2022 të datës 14.10.2022 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 31.05.2021 lidhur me sistemimin e tij në pozitë të kategorisë së mesme drejtuese, me arsyetimin se ankuesit i ka përfunduar mandati në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi me date 09.07.2020 nuk ka efekt retroaktiv, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejtë ka zbatuar ligjin material.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1008/2022

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Malsore Gashi - Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.